

RRUGA DREJT



TË ARDHMES

DEMOKRACIA E FËMIJËVE


NART (11), EROARD (11), JON (10), DRIN (10), TOMOR (11), VESA (10), VOLTISA (11), OLSA (10),
ALMA (11), DIELLA (11)

DEMOKRACIA



Ne jemi gazetarët e rinjë, dhe sot do të flasim për demokracinë

Demokracia është sistem përmes të cilit udhëhiqet një shtet. Të gjithë njerëzit kanë të drejtën e jetesës në demokraci. Por, gjithashtu të gjithë kanë të drejta të barabarta. Demokracia ka lindur në Athinë, Greqi, para shumë vitesh. Ajo ka disa elemente. Ne mund t'i veçojmë disa prej tyre: toleranca, aktivizmi qytetar,



garantimi i të drejtave të njeriut, etj. Ekzistojnë dy forma të demokracisë: demokracia e drejtpërdrejtë dhe demokracia përfaqësuese.

Të gjithë fëmijët, që nga momenti kur vijnë në jetë, marrin të drejtën e parë, të drejtën e jetesës. Pra, të gjithë kemi të drejtë të jetojmë. Duke u rritur, me kalimin e kohës, ne kemi edhe të drejta të tjera, p.sh.: e drejta e emrit dhe mbiemrit, e drejta e lojës ose argë-



timit, e drejta e të shprehurit të lirë, ajo e votimit, etj. Por, fëmijët kanë disa të drejta që i mbrojnë ata dhe nuk i lejojnë të punojnë deri sa të arrijnë moshën 18 vjeçare, duke iu lejuar kështu të drejtën e arsimit. Ja, ky ishte lajmi ynë për sot. Faleminderit shumë për vëmendje dhe mirëkuptim!



Gazetarët e „Demos-ti“

LIGJET E DEMOKRACISË

NISA (10), ANISA (11), ANDRRA (10), VESA (10), EGERT (10), ERDETA (10), ERTI (10), LORENA (10),
ART (10), LIRJON (10), ALDI (10)



Ne kemi vendosur që të kontribuojmë për demokracinë duke shkruajtur një artikull për të!

Demokracia është liri. Me demokraci kuptojmë të drejtat e barabarta për të dy gjinitë. Gjithashtu, ne e kuptojmë demokracinë si mundësi për shprehje të lirë, për të vepruar dhe për të lëvizur lirshëm.

Kuvendi është institucion, në të cilin deputetët bisedojnë për çështje të ndryshme që janë të rëndësishme për shtetin tonë. Populli zgjedh deputetët dhe ata punojnë në Kuvend. Detyrat e Kuvendit janë të përfaqësojë shtetin dhe popullin, të miratojë ose shfuqizojë dhe propozojë ligje, dhe të mbikëqyr punën e Qeverisë. Po ashtu, deputetët zgjedhin Qeverinë dhe Presidentin e vendit. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka tri funksione, të cilat janë funksioni legjisla-

tiv, sepse Kuvendi krijon ligje; funksioni i kontrollit, sepse Kuvendi kontrollon dhe mbikëqyr Qeverinë; si dhe funksioni përfaqësues, sepse Kuvendi përfaqëson popullin e Kosovës.

Në Kuvendin e Kosovës punojnë 120 deputetë, ku 100 janë të komunitetit shumicë, kurse 20 të tjerë janë të komunitetit jo shumicë.

Që të kemi demokraci, përveç që Kryeministri dhe ministrat duhet të plotësojnë përgjegjësitë tona, ne duhet të zbatojmë rregullat që shteti ynë i ka krijuar. Ne duhet të punojmë shumë që ta zhvillojmë vendin tonë. Secili në profesionet tona të ardhme do të kontribuojmë për Kosovën.



Demokracia sot me ngjyra dhe dikur e vyshkur



Autorët e artikullit

TË GJITHË E KEMI TË DREJTËN E VOTËS

KIANNA (11), VESA (11), GJIN (11), FIONA (11), ERA (11), MOREA (10), DORA (11), BLIN (11),
VLERDON (11), RRON (10)

Lexues të dashur, sot nga ne, nxënësit e klasës së V-të nga shkolla „Ismail Qemali„ do të kuptoni se pse janë zgjedhjet të rëndësishme në një shtet demokratik


Zgjedhjet janë zemra e demokracisë, sepse përmes tyre secili qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të zgjedh përfaqësuesit e popullit të vet. Ne si nxënës, në përditshmëri e përdorim procesin e votimit për zgjedhjen e çështjeve të ndryshme. Për shembull, ne zgjedhim ushqimet, rrobat, etj. Por, me padurim presim që edhe ne të jemi pjesë e zgjedhjeve shtetërore, sepse duam që të vërehet edhe ndikimi ynë. Shteti ynë, Kosova ka dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet qendrore, ku zgjedhen deputetët dhe zgjedhjet komunale, ku zgjedhet kryetari i komunës dhe asambleistët. Meqënëse vetëm një votë mund të bëjë ndryshim, iu ftojmë që secili prej juve të votoni dhe ta përmbushni përgjegjësinë tuaj si qytetarë. Vota juaj, ndryshim i vendit.



Votuesit e së ardhmes



Të gjithë e duam demokracinë



Votimi bën ndryshim, bëhu pjesë e ndryshimit



Të gjithë e kemi të drejtën e votës



Deputetët që populli i zgjedh punojnë në Kuvend

KUVENDI, INSTITUCION DEMOKRATIK

ORIK (11), KLOD (11), LYRA (11), JON R. (10), NUAR (11), VALA (11), SIBORA (10), DREDHËZA (10),
VALËZA (10), EDRIN (10)

Demokracia na mundëson që ne t'i zgjedhim përfaqësuesit tanë me anë të votës së lirë

E dini se çfarë do të thotë të jetosh në një shtet demokratik? Ne si fëmijë të Kosovës kemi fatin të jetojmë në një shtet demokratik, ku mund të shprehemi dhe të veprojmë lirshëm.

Një mënyrë e mirë se si të shprehim sovranitetin janë zgjedhjet, ku ne votojmë për deputetët, të cilët na përfaqësojnë neve dhe interesat tona në Kuvendin e Kosovës. Por, a e dini çfarë është Kuvendi? Kuvendi është institucioni më i lartë i shtetit, i cili udhëhiqet nga Kryetari i Kuvendit dhe është institucion prej të cilit dalin ligjet. Por, ligjet çfarë janë? Ligjet janë rregulla të shkruara, të cilat duhet t'i respektojmë dhe t'i zbatojmë detyrimisht. Këto rregulla vlejné për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim. Nëse ne nuk i zbatojmë këto ligje, do të dënohemi me gjobë. Për shembull: nëse një qytetar thyen një lokal dhe merr diçka që nuk i takon, atëherë ai do të gjykohej, e kjo e bën atë qytetar të përgjegjshëm.


Kosova është shtet shumë etnik, ku shumica e qytetarëve janë shqiptarë, ndërsa ata jo shumicë janë komuniteti romë, turk, ashkali, egjiptian, serb, goran dhe boshnjak. Pjesëmarrja e komuniteteve jo shumicë paraqitet edhe në flamurin e Kosovës, në formë të yjeve. Për ne, kjo ditë ishte shumë e veçantë sepse mësuam gjëra që nuk i kemi ditur më parë. Pra, mësuam për punën e deputetëve dhe detyrat që kryejné ata. Një ditë, kur ne të bëhemi deputetë do të organizojmë edhe më shumë programe të tilla si „Demos-ti“, sepse gjëra të tilla i duhen fëmijëve të vendit tonë.



Duke punuar në artikullin e grupit



Gazetarët e demokracisë



Konceptet për të cilat sot mësuam janë: demokracia, Kuvendi, ligji, etj.



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Ismail Qemali“
Klasa: V-4
Vendi: Prishtinë